



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:080392

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06347480

C.nr.280/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, në çështjen juridike kontestimore të paditëses F, ndaj të paditurës S.L nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kthim borxhi, me vlerën e objektit të kontestit prej 2,614.00 euro, pas seancës së mbajtur më datën 24.10.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET e tërhequr padia e paditëses F, ndaj të paditurës S.L nga Rahoveci, në çështjen kontestimore C.nr.280/2020.

Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja F, më datën 03.07.2020, në këtë gjykatë ka parashtruar padinë kundër të paditurës S.L nga Rahoveci, për shkak të objektit të kontestit – kthim borxhi, me vlerën e objektit të kontestit prej 2,614.00 euro.

Lidhur me këtë çështje kontestimore, kjo gjykatë për datën 24.10.2024 ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën seancë nuk ka prezantuar asnjëra palë ndërgjyqëse, edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar.

Gjykata ka vendosur ta konsiderojë të tërhequr padinë e paditëses për faktin se paditësi edhe pse kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 24.10.2024, e njëjta nuk ka prezantuar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Kështu, në nenin 423.3 të LPK-së parashihet që *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 409.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.280/2020, më datën 24.10.2024

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.